

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Pas mbledhjes së qeverisë, ministrat zbardhin vendimet: 110 mln euro me Gjermaninë, 7 mijë apartamente dhe fond për energjinë
ADRESA	https://top-channel.tv/2026/09/11/pas-mbledhjes-se-qeverise-ministrat-zbardhin-vendimet-110-mln-euro-me-gjermanine-7-mije-apartamente-dhe-fond-per-energjine64556/
BURIMI	top-channel.tv
GJENDJA	edited

KOHA


KAPUR NGA NE	11 shtator 2026, 09:16:50 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
LEXUAR NGA FAQJA	11 shtator 2026, 09:11:00 UTC <i>Portali nuk e deklaroi datën në asnjë formë makinë-lexueshme; kjo është ora e shkruar për njeriun, e lexuar nga faqja me meto dën text_date. Dritarja: 11 shtator 2026, 09:10:00 UTC → 11 shtator 2026, 09:12:00 UTC. Kalon nga një rregull i yni që mund t ë gabojë, prandaj shfaqet si e lexuar dhe jo si e deklaruar.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	9ab1a1f0831fd18b9a3aec1d459c28a8438b8b052439d88907fe8ddec0929405
TEKSTI	57790d6dfec2ca2fbbf02096cdf6b2500cb3b49d054e1963d8fb108b9b4e93f
PAMJA	2f748ebf722a4526497264db7df26e42f1bcfe539083ece754a73c33ba722faf

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	f1bdc2c823dac85e0d9e0cd53b34c97eaaa0acf7d73d93646241630abc66f6fc
E MËPARSHMJA	d7b07de28c660eb1184c5048fc6563e8badc8f68aac62f832fd30a913ec7b4c2
RRËNJA MERKLE	—
ANKORIMI	nuk është ankoruar ende <i>Kjo hyrje nuk është përfshirë ende në asnjë pemë Merkle të dërguar. Zinxhiri i hash-eve provon rendin dhe integritetin; koha jo.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/f1bdc2c823dac85e0d9e0cd53b34c97eaaa0acf7d73d93646241630abc66f6fc>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored · dritarja 1280×1024 px



- [Lajme](#)
- [Video](#)
- [Sport](#)
- [Pop News](#)
- [Programe](#)
- [Youtube](#)
- [Top News LIVE](#)

Accessibility options



- [Lajme](#)
- [Lajmet e fundit](#)
- [Politikë](#)
- [Kronikë](#)
- [Aktualitet](#)
- [Ekonomi](#)
- [Sociale](#)
- [Video](#)
- [Top News LIVE](#)

- [Bota](#)
- [Opinion](#)
- [Koment](#)
- [Kosova dhe Rajoni](#)
- [Shkencë dhe Teknologji](#)
- [Auto](#)

- [Video](#)
- [Programe](#)
- [Lajme](#)

- [Sport](#)
- [Kombëtarja](#)
- [Kategoria Superiore](#)
- [Kategoria e Parë](#)
- [Premier League](#)
- [La Liga](#)
- [Serie A](#)
- [Shumësportësh](#)
- [Sport Gossip](#)

- [Pop News](#)
- [Showbiz](#)
- [Lifestyle](#)
- [Fashion](#)
- [Shëndeti](#)
- [Dieta](#)
- [Receta gatimi](#)

- [Programe](#)
- [Big Brother VIP](#)
- [Për'puthen](#)
- [Shqipëria LIVE](#)
- [Fiks Fare](#)
- [Video](#)
- [Të gjitha programet](#)
- [Guida TV](#)

- [Top Channel](#)
- [Rreth Top Channel](#)
- [Bileta](#)
- [Kontakt](#)
- [Puno në Top Channel](#)
- [Privacy Policy & Terms of Use](#)
- [Aksesueshmëria](#)

Kërko...

[Kryesore Politikë Të Fundit](#)

Pas mbledhjes së qeverisë, ministrat zbardhin vendimet: 110 mln euro me Gjermaninë, 7 mijë apartamente dhe fond për energjinë

11/09/2026 11:11



Pas mbledhjes së qeverisë të zhvilluar këtë paradite, ministrat kanë bërë publike disa prej vendimeve dhe politikave që pritet të zbatohen në periudhën në vijim. Në fokus kanë qenë marrëveshjet e reja me Gjermaninë për investime në energji dhe infrastrukturë, reforma e strehimit, mbështetja për qytetarët përballë rritjes së kostove, si dhe çështje që lidhen me funksionimin e institucioneve dhe drejtësinë.

Ministri i Infrastruktūrës dhe Energjisë, Enea Karakaçi, njoftoi miratimin e tre marrëveshjeve me qeverinë gjermane, me një vlerë totale prej 110 milionë eurosh, ku 20 milionë euro janë në formën e grantit. Fondet do të përdoren për rehabilitimin e konvikteve studentore, ndërhyrje në hidrocentralin e Vaut të Dejës dhe digjitalizimin e sistemit të operatorit të transmetimit. Karakaçi foli gjithashtu për politikën e reja në sektorin energjetik dhe krijimin e një fondi për eficientë e energjisë.

"Kemi miratuar sot tre marrëveshje me qeverinë gjermane, 110 mln euro, 20 mln euro grant për tri projekte. 1. Vazhdimi i rehabilitimit të konvikteve të studentëve. 2. Bëhet fjalë për rehabilitimin e termocentralin e Vaut të Dejës. Si dhe programi 3 që përfiton është digjitalizimi i sistemit të operatorit të transmetimit.

Në kemi disa politika që po përpiqemi të zhvillojmë. Ke përfunduar dy programet e licencave për panele diellore me ujë të ngrohtë. Po bëjmë ndryshimin e ligjit të eficientës së energjisë, aty parashikohet edhe krijimi i një fondi të eficientës së energjisë. Do të ketë një fond që do t'u japë mbështetje qytetarëve dhe bizneseve", tha Karakacçi.

Ministria e Ekonomisë, Delina Ibrahimaj, u ndal te reforma e strehimit, duke bërë të ditur se qeveria synon të zgjerojë skemat e mbështetjes përtej kategorive në nevojë. Sipas saj, programi i ri parashikon vënien në dispozicion të 7 mijë apartamenteve, kredi të buta dhe kredi me zero interes, ndërsa për apartamentet me sipërfaqe më të mëdha parashikohet një normë interesi fikse prej 3%. Ibrahimaj tha gjithashtu se do të ketë subvencionim qiraje për 3 mijë apartamente, të destinuara për profesionistët e rinj.

"Është një reformë e cila u njoftua dje, në fakt, por ndërkohë, nga ana ligjore, është akoma duke u hartuar dhe diskutuar për nevojën që tashmë në vend ka për një reformë në strehim, i cili nuk duhet më t'u dedikohet vetëm shtresave në nevojë. Kjo nuk do të thotë që nuk do të ketë një vëmendje për shtresat në nevojë. Do të vazhdojmë të kemi vëmendje, siç kemi pasur gjatë gjithë viteve të kaluara, ku dua të theksoj se, që nga viti 2018, kur u miratua ligji për strehimin, ne kemi pasur rreth 31 mijë mbështetje për familje të cilat janë në nevojë, të dizavantazuara, kategori të cilat konsiderohen të varfra dhe kanë qenë të shpërndara në të gjithë Shqipërinë.

Në kemi pasur disa ndërhyrje ndër vite, ku mund të rendis ndërhyrjet që kemi bërë për subvencionimin e qirave, të cilat kanë qenë 14,512. Kemi dhënë 7,290 kredi të buta nëpërmjet strukturave të bashkive dhe të pushtetit vendor. Kemi përmirësuar kushtet e banesave për 6,078 banesa dhe, ndërkohë, kemi përmirësuar infrastrukturën për 1,375 zona të banuara. Dua të ndalem te ato që kemi bërë në fakt, vetëm konkretisht këtë vit. Në vetëm para disa javësh, çnallëm 300 kredi të buta për punonjësit e administratës publike. ndërkohë në disa çnallëm programin e ndërmirësimit të

kushteve të banesave, i cili do t'u dedikohet 678 familjeve në 26 bashki.

Ky program ka qenë shumë i suksesshëm dhe ka qenë një program i cili është kërkuar vazhdimisht nga bashkitë, pasi praktikisht Qeveria dhe bashkitë bashkëfinancojnë programe të përmirësimit të kushteve të banesave për ato kategori familjesh të cilat nuk e kanë mundësinë financiare për të përmirësuar kushtet e tyre. Ndërkohë që dje, sigurisht, përveç atyre që kemi bërë deri më sot, bëmë të ditur reformën e re, e cila do t'u dedikohet jo vetëm shtresave në nevojë, siç thashë dhe paraqita, por do t'u dedikohet edhe të gjithë atyre që janë profesionistë, që janë të rinj, që janë familje të reja.

Do të jenë 7,000 apartamente të cilat do të vihen në dispozicion në bazë të paketës së re ligjore që ne jemi duke përmbyllur, ku konkretisht do të jenë 4,000 kredi të buta, ku 2,000 do të jenë kredi me zero interes për apartamente të cilat janë deri në 60,000 euro vlerë, ku do t'u jepen profesionistëve të rinj dhe çifteve të reja. Ndërkohë që, për apartamente të cilat janë më të mëdha, duke qenë se vlera 60,000 euro limiton sipërfaqen e apartamenteve, ne duam të bëjmë një politikë të re për të gjitha familjet e reja me një apo më shumë fëmijë, në të cilën do të vihen në dispozicion 3,000 apartamente me një kredi të butë, me një normë interesi 3% fikse.

Të gjitha normat e interesit, edhe për kredinë me zero interes, edhe për kredinë me 3% interes, që sigurisht janë shumë favorizuese, por diferencat e normave të interesit do të mbulohen nga një fond i cili do të krijohet, do të quhet Fondi Kombëtar i Strehimit, i cili do të përmblidhë 3%-in që mblihdet nga bashkitë, i cili paguhet nga zhvilluesit dhe ndërtuesit; do të përmblidhë buxhetin e shtetit për sa i përket strehimit, por do të përmblidhë gjithashtu edhe mekanizma të tjerë të kredive të cilat vihen në dispozicion nga institucione financiare ndërkombëtare, por më konkretisht BEI-ja dhe Banka Europiane për Investime. Banka Europiane për Investime ka një program specifik për strehimin, i cili është shumë favorizues dhe do të futet brenda Fondit Kombëtar të Strehimit.

Në vijim, ne planifikojmë që do të vëmë në dispozicion gjithashtu subvencionim qiraje për 3,000 apartamente, të cilat do t'u dedikohen gjithashtu jo vetëm shtresave në nevojë, siç ka qenë më përpara, por do t'u dedikohen gjithashtu familjeve të reja dhe profesionistëve, të cilët sapo kanë mbaruar shkollën apo çifteve të reja, të cilët sapo kanë mbaruar shkollën, të cilët vendosin të jetojnë në një qytet apo vendosin që, pasi kanë mbaruar shkollën në kryeqytet, të kthehen në vendbanimin e tyre. Dhe ne do t'i mbështesim këto familje të reja me qëllim që t'u garantojmë një fillim të jetesës më të sigurt, pasi ne mendojmë që në Shqipëri, në fakt, strehimi është një çështje kryesore për qytetarët dhe shifrat e tregojnë qartë këtë.

Kemi më shumë se 80% të qytetarëve shqiptarë të cilët jetojnë në banesë në pronësinë e tyre dhe kjo do të thotë që një nga aspektet kryesore të sigurisë së jetesës lidhet me strehimin. Kjo është dhe arsyeja pse ne kemi vendosur të bëjmë këtë reformë të madhe, e cila nuk do të jetë vetëm një reformë në produktet dhe instrumentet që ne do të përdorim, por do të jetë një reformë tërësore edhe nga ana e mekanizmit të qeverisjes së këtij instrumenti, ku padiskutim, përveç produkteve që unë sapo përmenda, do të fillojmë ndërtimin e disa blloqeve ndërtimesh, të cilat do të kenë një përdorim. Në qumësht 30-40-30, ku 30% e ndërtesave do t'u dedikohen banesave sociale dhe shtresave në nevojë apo të dizavantazuara. 40% e banesave do t'i dedikohen strehimit të përbalueshëm, pra strehimit për atë kategori familjesh apo individësh që nuk konsiderohen të varfër, konsiderohen shtresë e mesme, por që gjithashtu nuk arrijnë dot të përballojnë vlerën e një banese në vitet e tyre të para të jetesës bashkë, të krijimit të familjes apo të punës. Dhe 30% do t'i dedikohet shitjes në tregun e lirë.

Kjo është një politikë e cila, në fakt, është studiuar nga ana jonë duke marrë në analizë të gjithë vendet e Europës, por edhe të rajonit e më gjerë. Është një politikë e cila ndikon në banesat në përgjithësi dhe në urbanizimin në përgjithësi të qyteteve dhe nuk lejon që të krijohen blloqe pallatesh ku ka vetëm një kategori shtrese, të cilat mund të kthehen në problematike në të ardhmen", u shpreh Ibrahimaj.

Top Channel

[Kryesore »](#)

[Sulm kibernetik në Berlin/ "Masakër" të dhënash, 1.4 milionë përfundojnë në 'Darknet'](#)
11/09 12:47

[Plagosën rëndë 3 persona gjatë një konflikti, arrestohet 19-vjeçari në Shijak, vijon puna për kapjen e bashkëpunëtorit](#)
11/09 12:38

[Gjergj Bojaxhi rrëfhet si rrallëherë: Pse lashë qytetin për jetën si fermer, bukën e bëj me grurin që mbijell vetë](#)
11/09 12:29

[Kryeministri Rama liron nga detyra ministrin e Brendshëm, Besfort Lamallari, Ervin Demo merr postin e tij](#)
11/09 12:20

[Dosja Balluku/ Bardhi: SPAK të kërkojë autorizimin e Kuvendit, nuk mund të ketë standard të dyfishtë](#)
11/09 12:07

[Vrasja e 24-vjeçarit në Shkodër, gjykata lë në burg Andri Vulaj/ I dyshuari hesht, mbrojtja kërkon hetim për plagët me thikë](#)
11/09 12:05

[Politikë »](#)

[Kryeministri Rama liron nga detyra ministrin e Brendshëm, Besfort Lamallari, Ervin Demo merr postin e tij](#)
11/09 12:20

[Dosja Balluku/ Bardhi: SPAK të kërkojë autorizimin e Kuvendit, nuk mund të ketë standard të dyfishtë](#)
11/09 12:07

["Këtu këmbë librazhdioti nuk shkel më"/ Qytetari i Përrenjasit debaton me deputetin Komici për reformën territoriale: Mblidhni mendjen se këtu vota nuk merrim më](#)
11/09 12:03

["Çdo të premte në të njëjtën orë"/ Rama njofton nisjen e takimeve të përvajshme mes deputetëve dhe qytetarëve: Pa fjalime dhe kundërshtime](#)
11/09 11:40

[Punimet e Konventës Republikane në Dallas, Berisha takim me drejtues të lartë të drejtësisë në SHBA](#)
11/09 11:30

[Debat i makinës e re të Ramës, ministria Ismaili: Është me qira, nevojë për sigurinë e kryeministrit](#)
11/09 11:19

Na ndiqni:

[Top Channel @topchannelalbania @tchbreakingnews Top Channel](#)
[Video »](#)

[Top Channel/ Prishet moti! Fundjava me paqëndrueshmëri dhe temperatura deri në 33-34 gradë](#)

[Top Channel/ Në gjyq për vrasjen e 24-vjeçarit! Andri Vulaj del sot para gjykatës, njihet me akuzat](#)

[Top Channel/"Albamono" rikthehet në Pogradec. Artistë nga 6 vende sjellin në skenë histori njerëzore](#)

[Top Channel/ Përrenjasi kundër bashkimit! Banorët përplasen me deputetin e PS-së](#)

[Top Channel/ Shqipëria kujton "11 Shtatorin"! SHBA dhe Shqipëria nderojnë viktimat dhe heronjtë](#)

[Top Channel/25 vjetori i 11 shtatorit, New York: Dronë formojnë Kullat Binjake në nder të viktimave!](#)
[Kryesore](#)

[Vila në Palasë, SPAK dhe vëllai i Tares me qëndrime të kundërta/ Prokuroria: Pasuri e fshehur e Ballukut; Gentë Tare: Është e Iglit, nuk ia shitëm Abazit](#)
10:43

[Ndryshimet në ministrinë e Punëve të Brendshme, reagon Rama: Lamallari do i bashkohet ekipit tim në Kryeministri](#)
10:19

[Dyshimet për rrëmbim dhe tetë vite pa përgjigje, Elvis Troge shpallet zyrtarisht i zhdukur](#)
11:38

[Rriten tensionet për Ishujt Falkland, presidenti i Argjentinës anulon vizitën në Mbretërinë e Bashkuar](#)
09:28

[Video/ Magjistar dhe maestro, Egnatia zyrtarizon në mënyrë epike rinovimin e yllit të skuadrës](#)
11:27

[Më të lexuarat](#)

[Akuzat e SPAK se bleu në mënyrë fiktive vilën e Ballukut, vëllai i Iglit Tares ndërhyr në Top Story: Ka qenë e Iglit, Abazi kërkoi t'ia blinte](#)

["Shumë shpejt do i japim fund historisë së pajustificueshme të rindërtimit", Rama me tone të ashpër për Veliajn: Prerja e kokës së kryeqytetit, eksperimenti më i rëndë social](#)

["Ambasadori amerikan do të zbarkojë në Shqipëri", Buzhala paralajmëron në "Top Story": Ai do ta zgjidhë çështjen "Balluku"](#)

[Nea ndërhyrja te Trumpi të Samiti i NATO-s/ Thaci për Ramën: I lam mirënjohës nga zemra, ores në evikim të pandikuar nga askush](#)

[Kryeministri Rama liron nga detyra ministrin e Brendshëm, Besfort Lamallari, Ervin Demo merr postin e tij](#)
“Kanë dalë email-et me arkitektin për vilën në Palasë”/ Shehaj përplasët me Rexhajn për dosjen e Ballukut, analisti: Ajo dy herë ka shkuar në Green Coast
Top Story/ “Zgjidhëm të keqen më të vogël për Kosovën”. Hashim Thaçi për Gjykatën Speciale: E shmangëm Rusinë, sot po paguaj çmimin në lekurën time
“Nga 3.7 e 6.5 milionë që i kanë, gjyqtarët i duan pagat deri 9.9 milionë”. ministri Malaj reagon pasi u kallëzua në SPAK: Zbatova ligjin, janë 40 milionë euro shtesë në vit
Karamuço në Top Story: Kreu i SPAK po mentoron dosjen Balluku, deri në tetor-nëntor pritet nëse do shkojë në gjyq
Ndryshimet në ministrinë e Punëve të Brendshme, reagon Rama: Lamallari do i bashkohet ekipit tim në Kryeministri

- [Lajme](#)
- [Lajmet e fundit](#)
- [Politikë](#)
- [Kronikë](#)
- [Aktualitet](#)
- [Ekonomi](#)
- [Sociale](#)
- [Video](#)
- [Top News LIVE](#)
- [Bota](#)
- [Opinion](#)
- [Koment](#)
- [Kosova dhe Rajoni](#)
- [Shkencë dhe Teknologji](#)
- [Auto](#)
- [Sport](#)
- [Kombëtarja](#)
- [Kategoria Superiore](#)
- [Kategoria e Parë](#)
- [Premier League](#)
- [La Liga](#)
- [Serie A](#)
- [Shumësportësh](#)
- [Sport Gossip](#)
- [Pop News](#)
- [Showbiz](#)
- [Lifestyle](#)
- [Fashion](#)
- [Shëndeti](#)
- [Dieta](#)
- [Receta gatimi](#)
- [Programe](#)
- [Big Brother VIP](#)
- [Për'puthen](#)
- [Shqipëria LIVE](#)
- [Fiks Fare](#)
- [Video](#)
- [Të gjitha programet](#)
- [Guida TV](#)
- [Top Channel](#)
- [Rreth Top Channel](#)
- [Bileta](#)
- [Kontakt](#)
- [Puno në Top Channel](#)
- [Privacy Policy & Terms of Use](#)
- [Aksesueshmëria](#)

© Top Channel 2001 - 2026 • Ndalohet riprodhimi i paautorizuar i përmbajtjes së kësaj faqeje.

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.